

## KONTRATË E PUNËMARRËSIT PËR ANËTARËSIM NË NJË PLAN PENSIONI TË KRIJUAR NGA PUNËDHËNËSI NË FONDIN E PENSIONEVE VULLNETARE "SIGAL"

Mbështetur në nenet 6 dhe 53 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" si dhe në nenin 3 të Rregullores nr. 2 datë 13.01.2011 "Për Përbajtjen e Kontratës dhe të Prospektit të Fondit të Pensionit", sot, më datë \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ nënshkruhet kjo kontratë me përfaqësuesit e palëve si më poshtë:

### PUNËMARRËSI (Anëtari)

Z/Znj \_\_\_\_\_ biri/e bija e \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_ dhe banues në adresën \_\_\_\_\_, i punësuar në subjektin \_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, nr. i sigurimit për pension privat \_\_\_\_\_, mbajtësi kartës së identitetit me numër \_\_\_\_\_, i cili në bazë të Kontratës së Punëdhënësit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ kërkon të sigurohet në Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL", për të marrë pjesë në skemën e pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.

### DHE

### SHOQËRIA ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA", me seli në Tiranë, Rr. "Donika Kastrioti", pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zviceriane (Pallati i Ri Teknoprojekt), me licencë nr. 2, datë 30.03.2011 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, "Për Administrimin e Fondit Vullnetar të Pensioneve" përfaqësuar nga **Z. Elvis PONARI**, me funksion Administrator i cili ka fuqi të plota për të nënshkruar këtë kontratë.

### Palët kontraktuese bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

##### Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve reciproke mes SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. dhe anëtarit të fondit, në përputhje me dispozitat ligjore.

#### Neni 2

##### Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është anëtarësimi në Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL" dhe sigurimi me pension vullnetar anëtarin e fondit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 3

##### Kushtet për përfitim

Punëmarrësi ka të drejtë të përfitojë pensione vullnetare nga anëtarësimi në Fondin e Pensionit Vullnetare "SIGAL" pasi ka plotësuar kushtet e mëposhtme:

- kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar
- 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar në shkronjën "a"
- Të bëhet i paaftë si rrjedhojë një sëmundje invalidizuese, e cila përcaktohet sipas vendimit të K.M.C.A.P (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë)
- Të ketë ndërprerë anëtarësimin në fond si rrjedhojë e vdekjes

e) Të jetë pjesë e një Kontrate Anëtarësimi të Punëdhënësit dhe të ketë lidhur kontratë anëtarësimi me Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL"

#### Neni 4

##### Llojet e Përfitimit

Me plotësimin e kushteve për përfitim, punëmarrësi ka të drejtë të përfitojë nga kjo kontratë:

- Pension Pleqërisë
- Pension Parakohshëm
- Pension Invaliditeti
- Tërheqje e Parakohshme

Nëse punëmarrësi vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, sipas përcaktimit të bërë në nenin 18 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" asetet në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

#### Neni 5

##### Pagesa e përfitimeve

Pagesa e përfitimeve pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligj bëhet:

- Në mënyrë të menjëhershme duke tërhequr të gjithë vlerën neto të aseteve në llogarinë e anëtarit të fondit**
- Në mënyrë periodike si pension duke përcaktuar pagesën mujore dhe periudhën e tërheqjes së saj**

Punëmarrësi i anëtarësuar në fondin e pensionit ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet, sipas mënyrave të mëposhtme:

- a. marrjen e pagesës së menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet të pensionit, ose një pjesë të saj;
- b. marrjen e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo një pjesë të saj nëpërmjet pagesave periodike që i përgjigjen asaj;
- c. përdorimin e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo të një pjesë të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme" të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës;
- d. kombinimin e mënyrave të cituara në pikat a, b, dhe c më sipër.

Anëtari i fondit të pensionit mund të zgjedhë të marrë asetet neto në llogarinë e tij të pensionit në formën e pagesave periodike të planifikuara sipas skedulit të përcaktuar në një kontratë të veçantë, që nënshkruhet midis punëmarrësit të anëtarësuar të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese.

Shoqëria administruese e fondit të pensionit detyrohet të njoftojë anëtarin 3-muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit.

Në raste të vdekjes së anëtarit të fondit përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, sipas nenit 18 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" asetet në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë.

## Neni 6

### Mënyra e Pagesës së Pensionit

Pensioni paguhet nga filialet e një banke të nivelit të dytë, sipas marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim nga SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a me anëtarin në momentin e caktimit të përfitimit, dhe/ose nga një subjekt tjetër i licencuar i rënë dakord ndërmjet Anëtarit, Fondit dhe Subjektit.

Shoqëria Administruese për çdo rast të vonuar në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike, detyrohet t'i paguajë anëtarit të fondit të pensionit shumën shtesë, në formë interesi. Shuma e interesit të pagueshëm tek anëtari i fondit për çdo pagesë të vonuar llogaritet proporcionalisht:

- (a) për çdo ditë vonese, duke filluar që nga dita e parë kur lind detyrimi për kryerjen e pagesës, deri në ditën kur kryhet pagesa;
- (b) mbi shumën e pagesës së vonuar.

Në llogaritjen e interesit do të përdoret norma e interesit TRIBID 12 mujore e kërkuar për pranimin e depozitave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 5%.

Në rastet e pamundësisë për të tërhequr personalisht mjetet në llogarinë e tij në Fond, për çdo arsye të dokumentuar, sipas kritereve të përcaktuara nga SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a., anëtari ka të drejtë të autorizojë personin e përcaktuar për të tërhequr të gjitha mjetet financiare të grumbulluara në llogarinë e tij. Përfitimet e pagueshme, kur personi i siguruar vdes, në momentin që krijohen rrethanat, i jepen trashëgimtarëve në formë shlyerje të llogarisë mbi bazën e dëshmisë së trashëgimisë që ata paraqesin tek SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

## Neni 7

### Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. është e detyruar që pasurinë e anëtarit ta administrojë në mënyrë profesionale në mbështetje me interesat e anëtarëve dhe në përputhje me parimet e depozitimit dhe për këtë:

- a) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. hap për secilin anëtar një llogari individuale të veçantë, në të cilën regjistrohen të gjitha pagesat e kontributeve të bëra nga punëdhënësi, ai vetë, ose për llogari të tij, si dhe të gjitha

mjetet e tjera që grumbullohen në këtë llogari si rezultat i fitimit të ardhur nga investimi.

b) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. pajis anëtarin me kontratën dhe kartën e anëtarësimit vullnetar.

c) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. nëpërmjet "**depozitarit**" krijon mundësinë që anëtari të njihet në çdo kohë me gjendjen e llogarisë së tij. Në çdo rast depozitari është përgjegjës për ruajtjen e aseteve të fondit të pensioneve. Ai, në veprimtarinë e tij është tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe nga çdo palë tjetër që ka lidhje me Shoqërinë Administruese. Ai siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit të shpërndahen në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.

d) Shoqëria administruese, në periudha të rregullta kohore dhe të paktën çdo 30 ditë, informon anëtarin për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aseteve në llogarinë e pensionit të anëtarit, datat e kontributeve dhe transferimet e aseteve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aseteve në kuota pensioni. Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit për çdo anëtar. Mënyrat e informimit janë me shkrim dhe/ose elektronikisht. Anëtari pajiset me kartën personale të anëtarësisë me të cilën do të ketë mundësi të informohet mbi gjendjen e aseteve në çdo kohë.

e) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. ka për detyrë të njoftojë brenda tre muajve anëtarët e saj për rastet kur pushon së ekzistuari si pasojë e bashkimit me një shoqëri tjetër administruese. Shpenzimet për transaksionet e transferimit të aseteve në një fond tjetër pensioni do të mbulohen nga shoqëria administruese që e ka përthithur shoqërinë.

f) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. publikon në mënyrë dhe afate kohore të përcaktuara në ligj, Raportin vjetor të kompanisë, të ardhurat e fondit, vlerën e njësive të investimeve, normën e fitimit, etj.

g) Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a., informon në çdo moment anëtarët për politikën e investimit si dhe për ndryshimet në veprimtarinë që ndikon në të ardhurat e tyre, kjo jo vetëm nëpërmjet faqes së Fondit por edhe në informacionet individuale që ju dërgojmë rregullisht çdo anëtar të fondit.

## Neni 8

### Strategjia e Investimit

Asetet e Fondit investohen në bazë të strategjisë afatgjatë të investimit të aseteve, me qëllim optimizimin e kthimit nga investimi, duke vepruar brenda nivelit të pranueshëm të rrezikut. Portofoli i Fondit do të përbëhet nga tituj afatgjatë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Politika e investimit paraqitet në Prospektin e Fondit bashkangjitur kësaj kontrate dhe e publikuar në faqen zyrtare.

## Neni 9

### Vlera neto e aseteve dhe vlera e kuotave të fondit të pensionit

1. Vlera totale e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit\*, është shuma e vlerave të të gjitha llojeve të aseteve të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore. Procedurën e konvertimit të kontributeve të pensionit në kuota, rregullat për përlllogaritjen e kuotave në përpjesëtim me shumën në llogarinë e anëtarëve të fondit të pensionit dhe për konvertimin e kuotave në para e për pagesën e parave anëtarëve të fondit të pensionit të përcaktuara në prospekt në përputhje me objektivat e investimit të fondit të pensionit.

2. Vlera neto e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t), rezulton nga diferenca mes vlerës totale të aseteve të fondit të pensionit, të një dite më parë (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

3. Vlera neto e aseteve për çdo kuotë pensioni, në ditën e vlerësimit, do të llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit me numrin total të kuotave të pensionit.

4. Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit, llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit, të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për kontribuesit gjatë ditës (t-1), të cilët kanë paguar kontributet në ditën (t-1), si dhe duke zbritur numrin e kuotave të tërhequra nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, apo të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).

5. Kuotat e pensionit të emetuara dhe të tërhequra nga fondi i pensionit regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të emetimit apo tërheqjes.

*\*\*Ditë vlerësimi"- nënkupton ditën "t" në të cilën bëhet përlllogaritja e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një ditë më parë "t-1".*

#### Neni 10

##### Të drejtat dhe detyrimet e Punëmarrësit Anëtar i Fondit

a) Punëmarrësi, nëpërmjet punëdhënësit të tij paguan rregullisht kontributet në llogarinë individuale të tij, në masën dhe kohën që përcaktohet në këtë kontratë.

b) Kontributet që ka paguar punëmarrësi në këtë skemë pensioni, mund t'i jepjen në çdo kohë, përpara plotësimit të moshës e të zgjidhjes së kontratës, pasi me parë, ky anëtar do të trajtohet sipas parashikimeve të neneve 88 pika 8 e 90 të ligjit, ku çdo pagesë e marrë nga anëtar i fondit të pensionit, sipas përcaktimeve të neneve 16 e 18 të ligjit, tatohet me tatimin mbi të ardhurat, si dhe kundrejt penaliteteve të përcaktuara në kontratë.

c) Anëtarët kanë të drejtë të transferojnë asete të tyre nga një fond në një tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese apo nga një shoqëri tjetër administruese dhe procedurën për këtë transferim, përfshirë edhe kostot e lidhura me të, në rastet kur ka bërë marrëveshje paraprake me një Fondin tjetër dhe ky i fundit, është dakord me një transferim të tillë.

e) Punëmarrësi vazhdon të mbetet anëtar i fondit edhe në rastet kur ka ndërprerë përkohësisht pagesën e kontributeve në llogarinë e tij personale

f) Punëmarrësi që ndërpret për një kohë të gjatë pagesën e kontributeve në llogarinë e tij personale, vazhdon të mbetet Anëtar i Fondit, deri në mbarimin e afatit të kësaj kontrate, përveç rasteve kur punëmarrësi ka kërkuar me shkrim të tërhiqet nga anëtarësimi në Fond.

g) Punëmarrësi mundet që, pa e njoftuar paraprakisht Shoqërinë Administruese, të rrisë apo zvogëlojë masën e pagesën së tij të kontributeve.

h) Punëmarrësi ka të drejtë që të vazhdojë anëtarësimin në Fond edhe pas skadimit të periudhës për të cilën është rënë dakord, pa një njoftim të veçantë me shkrim për Shoqërinë Administruese dhe pa marrë parasysh nëse janë paguar rregullisht kontributet në llogarinë e tij personale.

i) Punëmarrësi ka të drejtë të pajset me dokumentin që vërteton pagesën e kontributeve në llogarinë e tij, në çdo kohë që dëshiron si dhe me kartën e anëtarësimi vullnetar.

j) Punëmarrësi për pjesën e aksioneve, sipas aseteve që ka, pajset me një dokument si dëshmi e pronësisë së tij në fond. Dokumenti do të lëshohet çdo vit pas përfundimit të vitit kalendarik të anëtarësimi. Punëmarrësi, me nënshkrimin e kontratës merr përsipër të paguajë në afatet e përcaktuara të gjitha detyrimet kontributive që kanë si qëllim anëtarësimin e tij në fondin e pensionit.

#### Neni 11

##### Pagesa e Kontributeve

Në përputhje me legjisllacionin në fuqi palët bien dakord mes tyre për pagimin rregullisht të kontributeve për përfitime pension vullnetar në masën dhe periudhën si më poshtë:

a. Kuota mujore e Kontributit është \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ) lekë në muaj.

Nga të cilat:

a1.Nga punëdhënësi \_\_\_\_\_ lekë në muaj

a2.Nga punëmarrësi \_\_\_\_\_ lekë në muaj

b. Periudha e anëtarësimi fillon me \_\_\_\_\_ dhe mbaron me \_\_\_\_\_ .

#### Neni 12

##### Mënyra e Pagesës së Kontributeve

a) Punëmarrësi, nëpërmjet punëdhënësit të tij kontributet për pension vullnetar i paguan në mënyrë periodike, mujore, 3-mujore ose vjetore.

b) Kontributet e paguara për punëmarrësin nga punëdhënësi, ose persona të tjerë në emër dhe për llogari të tij, do të depozitohen në bankën me të cilën SH.A.F.P "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. ka lidhur marrëveshje, bashkë me fitimin e realizuar nga investimi i tyre.

c) Në rast se punëmarrësi ka ndërprerë për një kohë të gjatë pagesën e kontributeve ai vazhdon të mbetet anëtar i fondit, përveç rasteve kur ai deklaron se do të tërhiqet nga anëtarësimi.

d) Punëmarrësi mundet që pa njoftuar paraprakisht shoqërinë të rrisë ose të zvogëlojë masën e kontributit.

#### Nenin 13

##### Tarifat e Pjesëmarrjes dhe Shërbimit

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a., në zbatim të ligjit në fuqi për fondet e pensioneve vullnetare do të zbatojë këto tarifa ;

a) për koston e administrimit të fondit të pensionit, deri në masën 2.2% (dy pikë dy) të vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit;

b) për transferimin e aseteve të anëtarit nga fondi i pensionit ekzistues në një fond të ri pensioni do të aplikohet tarifa e transferimit e cila do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar.

c) tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aseteve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj.

d) për tërheqjet e parakohshme të aseteve, anëtarët e fondit të pensioneve do të paguajnë penalitete si më poshtë:

- 2 % të aseteve të tërhequra pas 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë

- 5 % të aseteve të tërhequra pas 10 deri 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë

- 10 % të aseteve të tërhequra pas 5 deri 10 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë

- 15 % të aseteve të tërhequra deri 5 vjet nga dita e pagesës së parë të kontributeve

Penalitetet e tërheqjes së parakohshme nuk do të aplikohen ndaj anëtarëve, të cilët kalojnë në një fond të tjetër pensionit vullnetar.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a merr përsipër që çdo rritje të tarifave të zbatuara do t'u njoftohet anëtarëve, të paktën dymbëdhjetë muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

#### Neni 14

##### Favorizimet fiskale

a) Kontributi i bërë nga çdo punëmarrës, anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi. Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 200.000 lekë dhe 15 përqind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit. Në rast se punëmarrësi është mbi 50 vjeç, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250 000 lekë dhe 25 përqind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit

b) Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër në emër dhe për llogari të punëmarrësit, anëtar i fondit të pensionit, për efekte fiskale nuk konsiderohen si të ardhura personale.

c) Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese.

#### **Neni 15** **Dispozita të përbashkëta**

Për çdo parashikim që nuk del qartë nga kjo kontratë, palët referojnë në të gjitha rregulloret dhe prospektin e shoqërisë administruese dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 16** **Kohëzgjatja e kontratës**

Kjo kontratë është e vlefshme nga data e hyrjes në fuqi deri në përfundimin e afatit të caktuar në nenin 9 të saj.

Punëmarrësi mund të përfitojë të drejtën për dalje jashtë përcaktimit të më sipër nga anëtarësimi në Fond, në rast të shfaqjes së paaftësisë (invaliditetit). Në këtë rast, paaftësia duhet të jetë e vërtetuar me vendimit të K.M.C.A.P. (komisioni i caktimit të aftësisë për punë), si institucione kompetente, që përcakton shkallën e invaliditetit.

Të gjitha ndryshimet e shtesat e kësaj kontratë bëhen në përputhje me ligjin për fondet e pensionit vullnetar dhe Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 17** **Zgjidhja e kontratës**

Nëse secila nga palët nënshkruese të kësaj kontrate kërkon të tërhiqet nga zbatimi i saj, atëherë ajo është e detyruar të njoftojë palën tjetër brenda një afati jo më pak se tre muaj nga data që ka vendosur të tërhiqet.

#### **Neni 18** **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, bëhet me mirëkuptim midis palëve, ose në rast të kundërt, çdo pale ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor.

#### **Neni 19** **Sanksione**

Punëmarrësi, anëtar i fondit merr njoftim paraprakisht për legjislacionin në fuqi lidhur me këtë kontratë dhe prospektin e fondit dhe e nënshkruan kontratën me vullnet të plotë e të lirë.

Punëmarrësi, anëtar i fondit mban përgjegjësi dhe detyrime ligjore të përcaktuara në rast të shkeljes së detyrimeve që ka kjo kontratë, deklarimeve të rreme apo paraqitjes së dokumentacionit të pavërtetë. Shoqëria Administruese është përgjegjëse para Punëmarrësit për dëmet e shkaktuara ose për përmbushjen jo në mënyrën e duhur të detyrimeve të saj, të përcaktuara sipas ligjit, statutit dhe në këtë kontratë. Shoqëria Administruese nuk është përgjegjëse, nëse dështimi ose përmbushja në mënyrën jo të duhur të angazhimeve është rezultat i rrethanave, në të cilat Shoqëria Administruese nuk mund të ndikojë.

#### **Neni 20** **Kufizimet e sanksioneve dhe klauzola përjashtuese**

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë pensioni nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzole gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

#### **Neni 21** **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët, pasi punëmarrësi është vënë në dijeni për të gjitha kushtet e referuara në prospekt dhe rregulloret e shoqërisë, i ka pranuar dhe angazhohet në zbatimin e tyre. Prospekti i bashkëlidhet kontratës së fondit të pensionit.

**Për SH.A.F.P. "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA"**

**ADMINISTRATOR**  
**Elvis PONARI**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

**ANËTARI**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

**V U L A**

Shërbimi për konsumatorin pranë:

SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA": Tel.+355 4 225 3407/8; Web: [www.fondisigal.com.al/](http://www.fondisigal.com.al/) E-mail: [info@fppsigal.com.al](mailto:info@fppsigal.com.al)  
Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Tel: 04 2269 329; Numri jeshil: 0800 6969; E-mail: [konsumatori@amf.gov.al](mailto:konsumatori@amf.gov.al)